



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201802045/2

Tiranë ___/___/2019

Lënda: *Rekomandim për garantimin e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në Qendrën e Zhvillimit "Pëllumbat", Tiranë.*

BASHKISË TIRANË

**DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHËRBIMIT SOCIAL
SHTETËROR
ZONJËS LUNEDA SUFALI**

**DREJTORIT TË QENDRËS SË ZHVILLIMIT "PËLLUMBAT"
ZONJËS ANILA SHENJTOLLI**

TIRANË

Një nga sfidat kryesore të veprimtarisë të institucionit tonë është mbrojtja, promovimi dhe garantimi i të drejtave të fëmijëve, e në mënyrë të dedikuar një nga grupet më të ndjeshme, e përbëjnë padyshim fëmijët me aftësi të kufizuara. Përmirësimi i shërbimeve që shoqëria jonë ofron për fëmijët dhe adoleshentët, promovimi i të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve në kujdesin shoqëror dhe shëndetësor, si dhe në të gjitha institucionet rezidenciale apo ditore, ku ata janë, përbëjnë pjesë të punës të përbashkët.

Seksioni i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve pranë institucionit të Avokatit të Popullit¹ ka kryer një inspektim të përgjithshëm në Qendrën e Zhvillimit "Pëllumbat", Tiranë.

Avokati i Popullit, pasi shqyrtoi informacionin nga monitorimi i realizuar, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor, t'ju parashtrojë përfundimet e këtij monitorimi, si më poshtë vijon.

¹ Data 8.10.2018

Objektivat e inspektimit:

- vlerësimi i dokumentacionit, procedurave dhe personelit, në zbatim të legjislacionit në fuqi;
- respektimi i të drejtave të fëmijëve në zbatim të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Metodologjia

Grupi inspektues i institucionit të Avokatit të Popullit, i përbërë nga juristë dhe një punonjës social, si metodologji pune ka përdorur:

- ***së pari***, zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesin e institucionit, informacion, i cili është hedhur në një formular standard për inspektimin;
- ***së dyti***, zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, në drejtim të respektimit të të drejtave të fëmijëve;
- ***së treti***, monitorimin e mjediseve dhe kushteve të institucionit, ku ofrohen shërbimet për fëmijët.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues i institucionit të Avokatit të Popullit ka zhvilluar bisedën përmbyllëse me drejtuesin e institucionit dhe stafin në shërbim të drejtëpërdrejtë me përfituesit, ku u adresuan problematikat e evidentuara gjatë inspektimit.

Nga drejtuesi i Qendrës së Zhvillimit, na u mundësua vënia në dispozicion e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të saj, miratuar nga Shërbimi Social Shtetëror. Misioni i saj është përmirësimi i statusit social të personave me aftësi të kufizuara duke zhvilluar potencialet për jetesë.

“...Aty sigurohet mbështetje dhe ndihmë për përfituesit dhe këshillim për familjet e tyre; strehim, asistencë, edukim dhe rehabilitim; ndërhyrje social-shëndetësore për të përfituar autonomi individuale për aktivitetet e përditshme dhe integrimin...”².

Profili social i Qendrës së Zhvillimit “Pëllumbat”

Qendra e Zhvillimit “Pëllumbat” Tiranë është qendër rezidenciale për personat me aftësi të kufizuara deri në moshën 25 vjeç.

² Sipas “Deklaratës së qëllimit” të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit, shkresa nr.prot. 1569/1, datë 7.7.2016, të SHSSH.

Financimi i qendrës realizohet me fondet e buxhetit të shtetit, nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Qendra e Zhvillimit ofron shërbime sipas standardeve të miratuara për personat me aftësi të kufizuara, që kanë nevojë për kujdes afatgjatë, e për të cilët mbajtja në familje është vlerësuar si e pamundur ose e papërshtatshme.

Qendra ka statusin e një qendre/institucioni publik kombëtar, në varësinë e Shërbimit Social Shtetëror. Fondi i pagave dhe shpenzimeve caktohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Sipas zërave të veçantë të buxhetit nga viti në vit ka patur rritje në drejtim të mbështetjes buxhetore. Kështu, zëri “602” në vitin 2017 për këtë institucion ishte në masën 8,300,000 lekë, ndërsa në vitin 2018, u rrit në masën 10,000,000 lekë.

Në zbatim të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ende nuk kanë përfunduar procesin e licensimit, si rrjedhojë e problematikës së mbartur ndër vite, atë të mos lëshimit të certifikatës së pronësisë nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë. Problematikë që është shtruar për zgjidhje, është ai i kalimit të të drejtës së pronësisë dhe/ose të drejtës së përdorimit të godinës, në listën e inventarit të pronave të paluajtshme publike të shtetit që u transferohen njësisive të qeverisjes vendore, në këtë rast Bashkisë së Tiranës. Ky ngërç ka sjellë edhe probleme në përthithjen e fondeve të investimeve për rregullimin e problemeve të infrastrukturës së kësaj qendre.

Numri i përfituesve të qendrës

Gjatë realizimit të inspektimit, në qendër ofroheshin shërbime për 17 përfitues/fëmijë: 11 djem dhe 6 vajza, të moshës 6-21 vjeç, por në qendër kishte dhe më të rritur, dhe konkretisht, ishte një vajzë 26 vjeçe.

Kapaciteti i saj ishte 36 veta. Patologjitë e sëmundjeve janë çrregullime të spektrit të autizmit dhe “sindroma down”.

Nga vlerësimi i diagnozës, 10 përfitues kishin probleme të autizmit, ndërsa pjesa tjetër, pra, 7 përfitues kishin problematika të prapambetjes së lehtë mendore dhe të “sindromës down”. Të gjithë përfituesit ishin rezidencialë, dhe nuk ka frekuentim si qendër ditore.

Nismën për dërgimin (referimin) e personave me aftësi të kufizuara në këtë institucion e ndërmarrin prindërit, kujdestari i caktuar me vendim gjykatë ose nga KMCAP-i, Policia e Shtetit, administratori shoqëror i njësisë administrative përkatëse, si dhe seksioni për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore në nivel bashkie. Ndërsa, për sa i përket vendimmarrjes për

sistemimin dhe akomodimin e personave më aftësi të kufizuar në qendër, ky vendim është kompetencë e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror. Kur sistemohen në këtë qendër, përfituesit janë të komisionuar nga SHSSH. Ekipi multidisiplinar i përbërë nga 5 persona, kryen vlerësimin e nevojave në periodicitetin 1 herë në 2 muaj, pra në këtë mënyrë kryhet rivlerësimi i përfituesve të qendrës.

Një ndër problemet e konstatuara ishte përkatësia sociale dhe gjendja ekonomike, ku shumica e fëmijëve vinin nga familje në gjendje të vështirë ekonomike, ndërsa vetëm 2 prej tyre vinin nga familje në kushte mjaft të mira ekonomike.

Menuja ditore dhe javore ishte e mirëpërcaktuar dhe e konsultuar nga mjekët, sipas specifikave shëndetësore individuale të fëmijëve/përfituesve. Praktikë mjaft e mirë, ishte konsultimi dhe përfshirja e vetë përfituesve në dëshirat për ushqimin dhe, përcaktimin së bashku me stafin të menuse ditore. Menuja javore e afishuar, pëmbante 4 vakte ushqimi, si dhe nënshkrimin nga një përfitues, si dhe përfaqësues të sektorit të financës, të sektorit social dhe të drejtorit të qendrës.

Kuota financiare për shpenzimet ditore ushqimore, e përcaktuar për këta fëmijë/ përfitues në këtë institucion rezidencial publik të përkujdesit shoqëror, ishte 500 lekë³. Konstatuam marrjen parasysh dhe zbatimin e njërit prej rekomandimeve të disa viteve më parë të institucionit të Avokatit të Popullit, për shtimin e kuotës financiare për përfituesit në institucionet publike rezidenciale të përkujdesit shoqëror.

Në një regjistër të veçantë mbaheshin procesverbalet e takimeve dhe vizitave të të afërmeve apo familjarëve me përfituesit.

Punë planifikohej dhe kryhej rregullisht për aftësimin e përfituesve të kësaj qendre në fusha të tilla, si: poçeri, sera dhe pikturë.

Punonjësit ishin të trajnuar për rreziqet e mundshme nga zjarri dhe për mbrojtjen përkatëse. Në korridoret e godinës ishin vendosur rregullisht bombolat e shuarjes së zjarrit, të cilat ishin të kolauduara brenda afateve dhe në funksion të rregullt.

Kutia e ankesave ishte e vendosur në mjediset e godinës.

³ Bazuar në udhëzimin nr.689, datë 2.10.2018, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”.

Burimet njerëzore

Struktura e qendrës ka gjithsej 20 punonjës me kohë të plotë dhe 2 punonjës me kohë të pjesshme, nga të cilët një është mjek neurolog dhe një sanitar.

Organigrama e qendrës përbëhet nga:

- Drejtori;
- Sektori i Shërbimit Social;
- Sektori i Administratës.

Administrimi i qendrës kryhet nga drejtuesi dhe përgjegjësi i sektorit, financiar. Ndërkohë, që punonjësit e sektorit të shërbimit social janë punonjës socialë, specialistët janë okupacionistë, fizioterapistë, ortofonistë, edukatorë, si dhe kujdestarë. Punonjësit e qendrës rezidenciale emërohen dhe lirohen nga detyra me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Social Shtetëror.

Shërbimet e ofruara në këtë qendër zhvillimi janë:

- Terapi intensive psikosociale për aftësimin mendor dhe rehabilitimin social me qëllim integrimin në komunitet;
- Shërbimin psikomotor për aftësimin dhe përmirësimin e parametrave psikologjikë, si dhe të motorikës, pjesë e së cilës janë terapitë okupacionale, ergoterapia, puna tek poçeria, tek serat e qendrës, pirografia, me ndihmën verbale dhe fizike të stafit;
- Aftësim i parametrave fizike të fëmijëve dhe të rinjve të saj;
- Shërbime specifike për aftësimin e individëve me çrregullime të spektrit autik apo të aftësisë për të komunikuar, ortofonia, logopedia;
- Shërbime rehabilitimi dhe terapi zhvillimi.

Katër fëmijë ishin të regjistruar dhe frekuentonin shkollën 9 vjeçare “Osman Myderizi”, Tiranë. Por, për arsye të problematikave shëndetësore, ndeshnin vështirësi në dërgimin e tyre në shkollë. Ndaj, po konsideronin si zgjidhje marrjen e mësuesit ndihmës brenda qendrës për këta nxënës.

Problematikë që na u referua për ndërmjetësim dhe zgjidhje është ajo e ngritjes së shërbimeve të reja për personat me aftësi të kufizuara, që mbushin moshën 21 vjeç, pra të moshës mbi 21 vjeç.

Në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Qendrës së Zhvillimit “Pëllumbat”, përcaktohet se moshë e përfituesve është deri në 25 vjeç. Ndërsa, në shkronjën “b”, të pikës 51, të vendimit nr.518, datë 4.9.2018, të Këshillit të Ministrave “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e

rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, përcaktohet, se moshë e përfituesve të shërbimit rezidencial për personat me aftësi të kufizuar është nga 0-21 vjeç.

Në këtë kuptim, kjo pikë e rregullores duhet unifikuar me parashikimin që bën ky vendim i Këshillit të Ministrave, për sa i përket vendosjes së kufirit të moshës për përfitimin nga shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar.

Një tjetër problematikë, që kërkon vëmendje, është transporti i fëmijëve. Aktualisht, drejtuesit e qendrës përpiqeshin për t’u ofruar me ndihmën e institucioneve të tjera. Shoferi në organigramë ishte dhe mirëmbajtës, ndërsa automjeti, të cilin e kishin donacion, ishte jashtë funksioni.

Mangësi e konstatuar ishte licenca, e cila sipas legjislacionit në fuqi duhet lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, për të përcaktuar qartësisht tipologjitë e shërbimeve që ofron ky institucion rezidencial publik.

Mjediset e institucionit

Një pjesë e godinës së kësaj qendre ishte në gjendje të rëndë, me plasaritje të mureve. Faktikisht, ajo është një godinë e ndërtuar rreth vitit 1953. Ndërtesa ka dy kate dhe një bodrum. Në katin e parë, nga 8 dhomat, 3 prej tyre, si dhe një tualet ishin tejet të amortizuara dhe kërkohej ndërhyrje e menjëhershme. Funksionale në këtë kat ishin 5 dhoma dhe dy tualete. Ndërsa në katin e dytë, 3 dhoma shërbenin si klasa (dhe ishin jashtë funksionit). 8 dhomat e tjera shërbejnë si dy dhoma ndenjeje, një mensë, një kuzhinë, një klasë, tre dhoma gjumi dhe një tualet. Ndërsa, në bodrum ishin 6 dhoma funksionale, por që kanë nevojë për rikonstrukcion. Njëra prej tyre shërbente për mësimin e poçerisë, një tjetër për luanterinë, kurse në dy dhomat e tjera janë vendosur kaldaja dhe depozitat e lëndës djegëse. Po ashtu, në bodrum është edhe magazina e qendrës. Nga 1245 m² sipërfaqe e kësaj godine, 310 m² ishin tërësisht të amortizuara dhe jashtë funksionit. Në këtë sipërfaqe, ishte e nevojshme ndërhyrja e menjëhershme.

Aktualisht, qendra ishte me funksion të përgjysmuar nga pikëpamja fizike, pasi në gjysmën e ndërtesës kishte plasaritje muresh, amortizim dhe në rrezik shembjeje. Gjithashtu, vërehej amortizim i dyerve të brendshme, si dhe mungesë e monitorimit me sistem kamerash.

Nga raporti i hartuar⁴ në gusht të 2018-ës mbi problematikat e qëndrueshmërisë së objektit “Gjeologjia dhe sizmiciteti”, ndër të tjera konkludohet se: “...në objektin Qendra e Zhvillimit “Pëllumbat”, duhet të ndërhyhet urgjentisht për përforcimin e bazamenteve dhe strukturës. Kushtet gjeologjiko-inxhinierike,

⁴ Në Gusht 2018, raport inxhinierik A.Hasalami.

ku është ndërtuar kjo qendër janë të dobëta dhe e favorizojnë rindërtimin e objektit dhe sigurojnë shfrytëzim pa probleme të tij. Në përfundim në Qendrën e Zhvillimit “Pëllumbat”, duhet të ndërhyhet urgjentisht për përfundimin e bazamenteve dhe strukturës....”.

Sistemi i ngrohjes funksiononte me kaldajë (me naftë), e cila siguron ngrohje qendrore për të gjithë qendrën. Por në disa ambiente, ngrohja sigurohej dhe me kondicionerë. Rikonstrukcion ishte kryer në mensën e qendrës, si dhe në një dhomë ndenjeje në katin e dytë të godinës.

Kuzhina është e pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme si: soba, frigorifer, aspirator dhe furrë pjekëse. Librezat shëndetësore të kuzhinierëve ishin të përditësuara. Kampionët ushqimorë ruheshin në kushte frigoriferike.

Nga vëzhgimet e kryera në institucion vërehet, se pajisja e dhomave të hospitalizimit me mjete hotelerie të tilla si: dollape dhe komoda ishte në kushte optimale. Në mjediset e jashtme të godinës, oborri ishte i mirësishtuar me lulishte, mjedis në të cilin zhvilloheshin aktivitete sociale dhe okupacionale.

Në kuadrin e garantimit, që fëmijët dhe përfituesit me aftësi të kufizuara, të marrin kujdesin e duhur dhe në kohën e duhur, dhe në përmbajtje të këtij inspektimi të realizuar në Qendrën e Zhvillimit “Pëllumbat”, Tiranë, ajo që konstatohet, jo vetëm për përfituesit e kësaj qendre, por në përgjithësi, në të gjithë vendin është si vijon:

- mungësi në ngritjen e shërbimeve të reja për personat me aftësi të kufizuara, që mbushin moshën 21 vjeç;
- mungesë e vazhdimësisë së shërbimeve të specializuara në mjediset e shtëpisë nga vetë prindërit, me qëllim garantimin e zhvillimit normal progresiv në interesin më të lartë të fëmijës, si dhe vijimësia e përpjekjeve për fuqizimin e familjeve dhe këshillimin e tyre në vazhdimësi;
- mungesë e informacionit nga ana e prindërve për strukturat përgjegjëse në nivel vendor për mbrojtjen e fëmijëve, për të garantuar vazhdimësinë e terapive nga shërbime të specializuara në nivel vendor.

Për këtë qëllim, në mbështetje edhe të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

REKOMANDJMË:

- Marrjen e masave për licensimin e Qendrës së Zhvillimit “Pëllumbat” Tiranë, nga Qendra Kombëtare e Licensimit, ku të përcaktohen qartësisht tipologjitë e shërbimeve, që ofron ky institucion rezidencial publik.
- Marrjen e masave për kalimin të të drejtës së pronësisë dhe/ose të drejtës së përdorimit të godinës së Qendrës së Zhvillimit “Pëllumbat”, në listën e inventarit të pronave të paluajtshme publike të shtetit që u transferohen njësisë të qeverisjes vendore, në këtë rast Bashkisë së Tiranës, gjë që do të zgjidhë po ashtu, edhe problemet në përthithjen e fondeve të investimeve për rregullimin e problemeve të infrastrukturës së saj.
- Marrjen e masave për rikonstruksionin dhe vënien në kapacitet të plotë funksionimi, të të gjitha mjediseve të godinës së kësaj qendre.
- Marrjen e masave për harmonizimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Qendrës së Zhvillimit “Pëllumbat”, me aktet nënligjore në fuqi, pra të përcaktohet kufiri i moshës së përfituesve deri në 21 vjeç. Marrjen e masave për sistemin e përfitueses 26 vjeçare, në një institucion tjetër të përkujdesit sipas kriterit të moshës.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara, lutemi shqyrtimin e këtyre rekomandimeve.

K O M I S I O N E R

Nejla PEKA